



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1864/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI143/20

Parashtrues

Radovan Paunović

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, UZVP-
ARJ nr.138/2019, të 3 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Radovan Paunović i përfaqësuar nga Miftar Islami, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, UZVP-ARJ nr.138/2019, të 3 dhjetorit 2019 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA.nr.73/18, të 13 qershorit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.784/13, të 13 dhjetorit 2017.
3. Parashtruesi i kërkesës kishte pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 18 qershor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës përmes shërbimit postar dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 12 tetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 21 tetor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe të njëjtë iu kërkuar që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesë) që tregon datën e pranimit të vendimit të kontestuar dhe autorizimin për përfaqësim të parashtruesit të kërkesës në Gjykatë. Po ashtu një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të njëjtës iu kërkuar që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesë) që tregon datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 23 tetor 2020, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi kopjen e fletë-kthesës që tregon datën e pranimit nga parashtruesi i kërkesës të vendimit të kontestuar.

11. Më 9 nëntor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi dokumentet e lartpërmendura.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 30 qershor 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.
16. Më 8 shtator 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Më 6 dhjetor 2011, Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: ZKK) me Aktvendim nr.186 aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe personit Radovan Paunovic, për bartjen (transferin) e paluajtshmërisë në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (në tekstin e mëtejme: RDPP). ZKK kishte konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet për regjistrim sipas Ligjit për Themelim të RDPP Nr. 2002/05.
18. Në një datë të pa specifikuar parashtruesi së bashku me personin R.P. në cilësinë e bashkë trashëgimtarëve parashtruan ankesë në Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK).
19. Më 8 shkurt 2013, AKK me Aktvendim Nr.03/82/12 shfuqizoi Aktvendimin e ZKK dhe urdhëroi që lënda kthehet në rivendosje. AKK konstatoi se ZKK ka zbatuar gabimisht ligjin e vjetër për marrëdhëniet detyimore, si dhe ngastrat 196-o dhe 197-o janë prona të evidentuara në zonën kadastrale Bablak të komunës së Ferizajt e jo në Babush ashtu siç ishte vendosur në vendimin paraprak të ZKK-së në Ferizaj.
20. Gjithashtu AKK kishte arsyetuar vendimin e saj se ngastrat në fjalë (196-o dhe 197-o) edhe në vendimin e ZKK së në Ferizaj ishin të evidentuara në emër të

Këshillit Popullor të Komunës dhe Pasuri Shoqërore-Rrugë në zonën kadastrale Bablak.

21. Më 26 shkurt 2013, ZKK me Aktvendim nr. 00186/2009 e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe personit R.P., me nga 1/2 e pjesës ideale të parcelës kadastrale nr.00196-0 në sipërfaqe 1120 m² dhe parcelës kadastrale 00197-0 në sipërfaqe prej 4408 m². ZKK theksoi se në rastin konkret sipas të dhënave të evidentuara në RDPP dhe fotove kemi të bëjmë me rrugë publike, (në gjatësi prej 678 m dhe gjerësi 6m).
22. ZKK-Ferizaj, në vendimin e njëjtë erdhi në përfundim se bazuar në Ligjin për Rrugët 2003/11 përcaktohet se asnjë personi juridik dhe fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike sidomos duke pasur parasysh se bartja e pronës do ta bënte të pamundur qasjen në rrugë të parcelave tjera të Zonës Kadastrale në Bablak të Ferizajt.
23. Më 11 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës dhe personi R.P., iniciuan konflikt administrativ kundër AKK-së duke kërkuar aprovimin e padisë, anulimin e vendimit të të paditurës AKK dhe të obligohet ZKK në Ferizaj që në emër të paditësve të regjistronen parcelat kadastrale 196-0 dhe 197-0 në RDPP me nga 1/2 të pjesës ideale.
24. AKK si palë e paditur e kishte kontestuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke i propozuar gjykatës themelore që vendimin e kontestuar ta lë në fuqi si vendim i drejtë dhe i ligjshëm. AKK theksoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për regjistrim të paluajtshmërisë nuk i plotëson kushtet e parashikuara në dispozitat përkatëse të Ligjit 2002/05 për Regjistrimin e Paluajtshmërive dhe të Ligjit për Rrugët 2003/11.
25. Më 13 dhjetor 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykim [A.784/13] e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e Aktvendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës nr. 03/82/13 të 23 majit 2013. Gjykata Themelore, mes tjerash, arsyetoi: (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës që parcelat kadastrale nr. 196-0 dhe 197-0 në ZK Bablak të barten në emër të tyre nuk mund t'i aprovojë të bazuara pasi që parcelat kadastrale në fjalë janë evidentuar si rrugë publike çka do të pamundësonte qasjen e parcelave kadastrale tjera në rrugën publike; (ii) neni 11 i ligjit nr. 2003/11 për Rrugët parashikon që asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike; dhe, se (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dokumentacion përkatës të vlefshëm për regjistrim të së drejtës në paluajtshmëri.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore dhe procedurës administrative, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës propozoi që ankesa të miratohet dhe që aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe që rasti të kthehet për shqyrtim të sërishëm dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

27. Më 13 qershor 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykim [Aa.nr.73/18] vendosi që ta refuzojë të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, [A.784/13] të 13 dhjetorit 2017.
28. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor me të cilën kontestoi në tërësi ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar, për shkak të shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që kërkesa të miratohet ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.73/2018 i 13 qershorit 2019 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nr.784/2013 i 13 dhjetorit 2017 të anulohen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për shqyrtim të sërishëm dhe rivendosje.
29. Më 3 dhjetor 2019, Gjykata Supreme me Aktgjykim [UZVP-ARJ.nr.138/2019] e refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Aa.nr.73/18] të 13 qershorit 2019.
30. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) bazuar në Ligjin për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nr. 2002/ 5 përcaktohet që parashtruesi i kërkesës për regjistrimin e të drejtave të pronësisë së paluajtshme duhet të bashkëngjisë krahas kërkesës dokumentacionin e nevojshëm që vërteton të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme; (ii) e drejta e pronësisë mbi pronën e paluajtshme e paraparë në nenin 2 të të njëjtit Ligj, regjistrohet në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë, vendimit të organit administrativ, kontratës mbi transferimin e të drejtave të pronës së paluajtshme të vërtetuar tek autoriteti kompetent, vendimit ose kontratës së privatizimit të lëshuar nga AKP-ja, vendimit të komisionit kadastral, komisionit për rregullimin e tokës, si dhe dokumenteve të tjera më të cilat regjistrohen të drejtat pronësore përmes ligjeve të veçanta; dhe, se (iii) në nenin 11 të Ligjit për Rrugët, Nr. 2003/11, përcaktohet se asnjë personi fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Ati i janë shkelur të drejtat e garantuara kushtetuese që burojnë nga neni 24 dhe 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kjo për shkak të faktit se e drejta në pronë është një nga parimet themelore të aktit më të lartë juridik të shtetit, ndërsa vetë e drejta e pronës e përcaktuar bazuar në barazimin Gjyqësor P.nr.162 / 98 e 02.12.1998 Aktvendimin për kthimin e tokave nga Komisioni Komunal për kthimin e pronave -04Nr.465-11 i datës 23.01.1992, përndryshe një nga mënyrat në të cilën kjo e drejtë është fituar në përputhje me dispozitat e nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhëniet pronësore-juridike (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së” Nr. 6/80), i cili ishte në fuqi në kohën e Barazimit Gjyqësor të lartpërmendur dhe bazuar në Vendimin e organit shtetëror - Gjykata, duke treguar se nga 3 parcelat kadastrale të cilat në përputhje me barazimin e mësipërme janë*

njohur si pronë e palës e paditëse, regjistrimi në kadastrë është bërë vetëm për parcelën KP.br.607, ndërsa në lidhje me parcelat KP.nr.196 dhe 197 ZK Bablak, është refuzuar regjistrimi, për arsyen e lartpërmendur të dy parcelat në fjalë pretendohen të jenë “Rrugë publike”, dhe që si të tilla nuk mund të jenë subjekt i trafikut ose i regjistrimit.”

33. Parashtruesi i kërkesës thekson se nuk bëhet fjalë për “rrugë publike” por për një toponim kadastral “rruga mbretërore”. Parashtruesi i kërkesës shton se i ka dorëzuar instancave të rregullta gjyqësore konstatimin e ekspertit-gjeodetit të licencuar, i cili pas shikimit të parcelave kadastrale kishte përcaktuar se bë fjalë për “tokë bujqësore.”
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i shprehur në Aktgjykimin UZVP-ARJ.nr.138/2019 të datës 03.12.2019(faqja e), paragrafi i fundit , rreshti 14-16 është thjeshtë i palogjikshëm në situatën e cekur më lartë, marrë parasysh se instanca më e lartë gjyqësore ka konstatuar , se në rastin konkret Barazimi gjyqësor P.nr.162/98 i datës 02.12.1998 është në bazë të të cilit mund të bëhet regjistrimi i të drejtave të pronësisë në operatin e kadastrit por se vet regjistrimi në libra përkatësisht zbatimi i tij nuk mund të kryhet, duke iu referuar ne nenin 1.1 të Ligjit për Rrugët, përkatësisht për shkak se gjoja është fjala për rrugë publike.”

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI NR. 2002/5 PËR THEMELIMIN E REGJISTRIT TË TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 2 [Të drejtat e pronave të paluajtshme]

2.1 Të drejtat e pronave të paluajtshme, ashtu siç rregullohen me dispozitat e ligjeve ne fuqi, që i takojnë tokës, ndërtesave dhe banesave (në tekstin e mëtejme: “pronat e paluajtshme”) do të regjistrohen në Regjistër.

2.2 Të drejtat e pronave të paluajtshme përfshijnë:

- a. pronësinë;*
- b. hipotekat;*
- c. servitutet;*
- d. të drejtat e shfrytëzimit të pronave shoqërore dhe pronave shtetërore.*

Neni 3 [Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme]

3.1 Kërkesat për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme i parashtrohen me shkrim ZKK-së në territorin ku ndodhet prona e paluajtshme. ZKK-ja do të konfirmojë datën dhe kohën e pranimit të kërkesës për regjistrim.

3.2 Parashtruesi që kërkon regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme, kërkesës duhet t’ja bashkangjes dokumentacionin

përkatës për të mbështetur të drejtën e pronës së paluajtshme siç kërkohet me ligjin në fuqi të përcaktuar me nenin 3.7 të këtij ligji.

[...]

Pa prejudikuar nenin 1.2 (b) të Rregullores Nr. 1999/23, të UNMIK-ut (mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje pronësore-banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore-banesore) ZKK-ja do të regjistrojë të drejtën e pronës së paluajtshme në Regjistër vetëm nëse gjykata kompetente i ka dhënë dokumentin përkatës me shkrim ZKK-së për regjistrimin e të drejtës së pronës së paluajtshme në Regjistër.

LIGJI PËR RRUGËT Nr. 2003 / 11

Neni 11

Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjkata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Gjkata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjkata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

38. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [UZVP-ARJ.nr.138/2019] të 3 dhjetorit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
39. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ata pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kriteret nga neni 48 i Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
40. Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2, i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:
- “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
41. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës sepse Gjykata Supreme nuk ka vlerësuar *“barazimin gjyqësor P.nr.162/98 i datës 02.12.2018 është në bazë të të cilit mund të bëhet regjistrimi i të drejtave të pronësisë”* duke iu referuar në nenin 1 të Ligjit për Rrugët, *“për shkak se gjoja është fjala për rrugë publike.”*
42. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, pretendon se ai posedon dokument të vlefshëm me ligj (barazimin gjyqësor P.nr.162/98 i datës 02.12.2018) për regjistrim të paluajtshmërisë në RDPP mirëpo që nuk është vlerësuar si i tillë nga gjykatat e rregullta me arsyetimin se paluajtshmëritë në fjalë janë rrugë publike dhe si të tilla-bazuar në ligjin për rrugët-nuk mund të barten në pronësi të personave fizik dhe juridik. Parashtruesi po ashtu pretendon se parcelat kadastrale për të cilat ka kërkuar që të barten në emër të tij në RDPP nuk janë rrugë publike, prandaj, arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta nuk qëndron.

43. Gjykata në vijim, do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
44. Në tekstin e mëposhtëm, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me të drejtën për mbrojtje të pronës dhe të drejtën për barazi para ligjit dhe mos diskriminim.

(i) Pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të KEDNJ-së

45. Për sa i përket të drejtës për mbrojtje të pronës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon: “ [...] për shkak të faktit se e drejta në pronë është një nga parimet themelore të aktit më të lartë juridik të shtetit, ndërsa vetë e drejta e pronës e përcaktuar bazuar në barazimin Gjyqësor P.nr.162 / 98 e 02.12.1998, përndryshe një nga mënyrat në të cilën kjo e drejtë është fituar në përputhje me dispozitat e nenit 20 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhëniet pronësore-juridike (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së” Nr. 6/80), i cili ishte në fuqi në kohën e Barazimit Gjyqësor të lartpërmendur dhe bazuar në Vendimin e organit shtetëror [...] Gjykata, duke treguar se nga 3 parcelat kadastrale të cilat në përputhje me barazimin e mësipërme janë njohur si pronë e palës e paditëse, regjistrimi në kadastrë është bërë vetëm për parcelën KP.br.607, ndërsa në lidhje me parcelat KP.nr.196 dhe 197 ZK Bablak, është refuzuar regjistrimi, për arsien e lartpërmendur të dy parcelat në fjalë pretendohen të jenë “Rrugë publike”, dhe që si të tilla nuk mund të jenë subjekt i trafikut ose i regjistrimit.”
46. Gjykata rikujton se bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, koncepti i pronës (possessions) i përmendur në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ka kuptim autonom që nuk kufizohet në pronësi të të mirave materiale dhe është i pavarur nga klasifikimi formal nga e drejta vendore: disa të drejta dhe interesa tjera që janë vlera (assets) gjithashtu mund të konsiderohen si të “drejta pronësore” (property rights) dhe rrjedhimisht “pronë” (possessions) për qëllime të kësaj dispozite. Çështja që duhet vlerësuar në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, shikuar në tërësi, i akordojnë parashtruesit titull ndaj një interesi material të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (shih rastin e GJEDNJ-së, *Bronioëski kundër Polonisë*, Aktgjykim i 28 shtatorit 2005, paragrafi 129).
47. Në disa rrethana, “pritjet legjitime” (legitimate expectation) për të fituar një “vlerë” (asset) po ashtu mund të gëzojë mbrojtje nga neni 46 në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. Prandaj, kur një interes pronësor shprehet në formë të pretendimit, personit që i është veshur ai interes mund të konsiderohet se ka “pritje legjitime” nëse për atë interes ka bazë të mjaftueshme në të drejtën vendore, për shembull kur ka jurisprudencë të konsoliduar të gjykatave vendore që konfirmojnë ekzistencën e tij (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kopecky kundër Sllovakisë*, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 52). Mirëpo, asnjë pritje legjitime nuk mund të thuhet se është ngritur në rastet ku ka mosmarrëveshje lidhur me zbatimin dhe interpretimin e drejtë të së drejtës vendore dhe ku më

pas pretendimet e parashtruesit janë refuzuar nga gjykatat vendore (shih rastin e GJEDNJ-së, *Kopecky*, të cituar më lart, paragrafi 50).

48. Gjykata vlerëson se pavarësisht nga larmia e shprehjeve në jurisprudencën e GJEDNJ-së që i referohen kriterit që përcakton se baza ligjore vendore krijon interes pronësor, thelbi i tyre në përgjithësi mund të përmbledhet si vijon: për njohjen e pronës (*possession*) që konsiston në pritje legjitime, parashtruesi duhet të ketë një të drejtë të njohur (*assertable right*) që nuk bie përfundi interesit material pronësor të përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme nga e drejta vendore (shih Udhëzuesin e Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së të përditësuar më 30 prill 2021, Kapitulli II Çështje të përgjithshme, 1. Koncepti i pronës, i pritjet legjitime, paragrafi 25).
49. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson pretendimi i parashtruesit të kërkesës që t'i njihet e drejta në pronë bazuar në barazimin gjyqësor 162/98 të datës 02.12.1998, megjithatë, nuk është “pritje legjitime” apo e “drejtë e njohur” e interesit material pronësor të përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme nga e drejta vendore.
50. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se paluajtshmëria që ai kërkon ta regjistrojë në RDPP nuk është rrugë publike, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte shpjeguar: (i) bazuar në nenin 11 të ligjit për rrugët, bartja e pronësisë në rrugë publike nuk miratohet për personat fizik dhe juridik; dhe (ii) bartja e pronësisë në RDPP në emër të parashtruesit të kërkesës do të pamundësonte qasjen e parcelave kadastrale tjera në rrugën publike (shih paragrafin nr. 8 të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.784/13). Ky arsyetim i Gjykatës Themelore po ashtu është miratuar edhe nga Gjykata Supreme.
51. Gjykata po ashtu vëren se pjesa relevante e aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton:

“Në rastin konkret, kjo gjykatë konsideron se mundësia e regjistrimit të pasurive të patundshme në fjalë të paditësve është e diskutueshme, duke marrë parasysh të dhënat në dispozicion të Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Ferizajit. Në të vërtetë, bazuar në provat në shkresat e lëndës, Certifikata-22-2768 e datës 22.02.2013 për parcelën kadastrale 196-0 dhe Certifikata-22-2799 e datës 25.02.2013 për parcelën kadastrale 197-0, kjo gjykatë konstatoi se parcelat kadastrale të sipërpermendura në operatin kadastral trajtohen si pronë shoqërore-rrugë publike. Me Nenin 11 të Ligjit për Rrugët, Nr. 2003/11, përcaktohet se asnjë personi fizik nuk i miratohet kërkesapër bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjesë të rrugës publike. Duke pasur parasysh dispozitën e mësipërme të Ligjit për Rrugët, kjo gjykatë konsideron se e paditura-Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vepruar në mënyrë të drejtë dhe të përcaktuar me ligj kur me vendimin e kontestuar Nr. 03/82/13 të datës 23.05.2013 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve të parashtruar kundër vendimit të Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Ferizaj 00186/2009 datë 26.02.2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësve për bartjen e pronësisë së pasurisë e paluajtshme, përkatësisht të parcelave kadastrale nr. 196-0 dhe nr. 197-0.”

52. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se sado i kuptueshëm që mund të jetë pretendimi i parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të pronës, megjithatë, pretendimi i tij nuk mund të konsiderohet “pritje legjitime” nga neni 46 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sepse gjykatat e rregullta mjaftueshëm kanë shpjeguar përse paluajtshmëria nuk mund të bartet në RDPP në emër të tij duke mbështetur vendimet e tyre në dispozitat përkatëse të ligjit për rrugët.
53. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesi i kërkesës për shkelje të nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimi për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së

54. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për cenim të së drejtës për barazi para ligjit, Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të GJEDNJ-së në mënyrë që një çështje të ngrehet nën nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] aty duhet të ketë dallim në trajtim të personave në situata analoge ose që janë në mënyrë relevante të krahasueshme (shih, mes shumë autoritetesh tjera, *Khamtokhu dhe Aksenchik kundër Ruisë*, Aktgjykim 2017 paragrafi 64; *X dhe të tjerët kundër Austrisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 98; dhe *Konstantin Markin kundër Ruisë*, Aktgjykim 2012, paragrafi 125). Me fjalë të tjera, kriteri për demonstrimin e pozitës analoge nuk kërkon që grupet e krahasuara (*comparator groups*) të jenë identike. Një parashtrues duhet të demonstrojë, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankesës së tij apo të saj, që ai ose ajo ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme (*relevantly similar situation*) me të tjerët që janë trajtuar ndryshe (shih *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim 2010, paragrafi 66). Megjithatë, jo çdo dallim në trajtim rezulton me shkelje të nenit 14. Së pari, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se vetëm dallimi në trajtim bazuar në karakteristika të identifikueshme, ose “status”, janë në gjendje të rezultojnë me diskriminim në kuadër të nenit 14 (shih *Carson dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 61, dhe *Eëeida dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48420/10, paragrafi 86, Aktgjykim 2013). Së dyti, dallimi në trajtim është diskriminues nëse nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm; thënë ndryshe, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih *Fabris kundër Francës* Aktgjykim 2013, paragrafi 56; *Topčić-Rosenberg kundër Kroacisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 36; dhe *Èeller kundër Hungarisë*, Aktgjykim 2009, paragrafi 27).
55. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar apo identifikuar individin apo grupin në krahasim me të cilin është diskriminuar dhe me të cilin ai ka qenë në një situatë që në mënyrë relevante është e krahasueshme. Barra e të provuarit për trajtim diskriminues bie mbi parashtruesin e kërkesës çka bazuar në shkresat e lëndës është evidente se pretendimin për diskriminim ai nuk e ka provuar. (shih *Khamtokhu dhe Aksenchik*, cituar më lart, paragrafi 65; *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aktgjykim 2013, paragrafi 85; dhe *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, Aktgjykim 2007, paragrafi 177).

56. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesi i kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
57. Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës.
58. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 shtator 2021, me shumicë

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani